



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1249/5 prot.

Datë 29/06/2022

V E N D I M

Nr. 616/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29/06/2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EURO - ALB” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-30029-05-19-2022, me objekt “Mbyllje kanali të hapur në rrugën Papa Klemendi II (550ML)” me fond limit 4,166,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.06.2022, nga autoriteti kontraktor BASHKIA DURRËS.

Ankimues:

“EURO - ALB” ShPK
Adresa: Rruga “Frosina Plaku”, Pallati. 60, Kati 1, Hyrja. 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

BASHKIA DURRËS
Adresa: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraparak

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik “EURO - ALB” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.05.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjehtuar”, me Nr. REF-30029-05-19-2022, me objekt “Mbyllje kanali të hapur në rrugën Papa Klemendi II (550ML)” me fond limit 4,166,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.06.2022, nga autoriteti kontraktor BASHKIA DURRËS

II.2. Në datë 03.06.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 08.06.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "EURO - ALB" SHPK	3,234,180	lekë	skualifikuar
2. "Caushi M" SHPK	3,483,300	lekë	skualifikuar
3. "ASI – 2A CO" SHPK	3,533,290	lekë	kualifikuar
4. "SARDO" SHPK	3,641,200	lekë	kualifikuar
5. "SARK" SHPK	3,776,839	lekë	kualifikuar
6. "K.TRUJA" SHPK	3,800,650	lekë	skualifikuar
7. "VARAKU E" ShPK	4,064,300	lekë	kualifikuar
8. "K-AAV" SHPK	4,127,324	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 08.06.2022, operatori ekonomik "EURO - ALB" SHPK është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave. Operatori ekonomik "EURO - ALB" SHPK është skualifikuar me argumentin e mëposhtëm:

"Nuk përmbush pikën 2.3.c të Kapacitetit Teknik për personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, pasi inxhinieri i ndërtimit i paraqitur dhe vetëdeklaruar, Z. Viktor Shota, nuk rezulton të jetë drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 14.06.2022 operatori ekonomik "EURO - ALB" SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe në datën 13.06.2022 ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1249/2 date 14.06.2022, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "EURO - ALB" SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.7. Me shkresën nr. 2581/6 prot, datë 23.06.2022 me objekt: "Vendim i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës", drejtuar KPP-së protokolluar me tonën me nr. 1249/4 prot., datë 28.06.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "EURO - ALB" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor rezulton, se AK ka marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik "EURO - ALB" SHPK përpara afatit të parashikuar në nenin 110 të LPP-së, pasi në datën 14.06.2022 nga AK nuk është publikuar akoma njoftimi i fituesit (apo njoftimi i anulimit) të procedurës së prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 24.05.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-30029-05-19-2022, me objekt “*Mbyllje kanali të hapur në rrugën Papa Klemendi II (550ML)*” me fond limit 4,166,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.06.2022, nga autoriteti kontraktor BASHKIA DURRËS.

III.1.1. Referuar materialeve të depozituara në Komisionin e Prokurimit Publik, rezulton se në datën 08.06.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) në procedurën e mësipërme të prokurimit. Njëkohësisht operatori ekonomik “EURO - ALB” SHPK është njoftuar nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (SPE) në lidhje me arsyen e skualifikimit.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se nga ana e autoriteti kontraktor nuk është publikuar njoftimi i fituesit (njoftimi i anulimit) në SPE.

III.1.3. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “*Afatet për ankimim*” të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. **Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**”.

III.1.4. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.1.5. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, **është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.**

Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën nr. Me shkresën nr. 2581/6 prot, datë 23.06.2022 me objekt: “*Kthim përgjigje ankesës nr.1249 prot., datë 13.06.2022*”, drejtuar KPP-së protokolluar me tonën me nr. 1249/4 prot., datë 28.06.2022, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është publikuar njoftimi i fituesit apo njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. KPP vëren, se operatori ekonomik “EURO - ALB” SHPK ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor në datën 14.06.2022 dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 13.06.2022, i cili kërkon kualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, ndërkohë nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), rezulton se autoriteti kontraktor ende nuk ka publikuar në sistemin elektronik të prokurimit aktin e “njoftim-fituesi” apo “njoftim-anulimi”, moment procedural nga i cili fillon afati i ankimimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”,

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit apo njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk ka filluar ende, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka publikuar njoftimin e fituesit apo njoftimin e anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e mësipërme e depozituar në autoritetin kontraktor në datat 14.06.2022, si dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në datat 13.06.2022, konsiderohen të paraqitura përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se:

“ Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

III.1.7. Lidhur me vendimin e autoritetit kontraktor Nr. 2581/6 prot, datë 23.06.2022, me anë të së cilit ka vendosur refuzimin ankesës të operatorit ekonomik ankimues “EURO - ALB” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon, se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e parashikuar nga nenet 110 dhe 111 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit

kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetiniciator i fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe që plotësojnë kushtet formale të ankesës, ku një prej të cilave është dhe respektimi i afateve të ankimit. Pra, komisioni i shqyrtimit të ankesave në asnjë rast nuk duhet të marrë në shqyrtim një ankesë e cila është paraqitur në mungesë të kushteve formale dhe respektimit të afateve të ankimit. Për këtë arsye, Komisioni gjykon, se vendimi i komisionit të shqyrtimit të ankesave për refuzimin ankesës të operatorit ekonomik “EURO - ALB” SHPK, është në kundërshtim të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndaj ky vendim do të shpallet absolutisht i pavlefshëm nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “EURO - ALB” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-30029-05-19-2022, me objekt “Mbyllje kanali të hapur në rrugën Papa Klemendi II (550ML)” me fond limit 4,166,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.06.2022, nga autoriteti kontraktor BASHKIA DURRËS.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e marrë prej saj nr. 2581/6 prot, datë 23.06.2022 me objekt “Vendim i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës” për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorët “EURO - ALB” ShPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri